
INVESTITORI
“ERONA COMPANY” SH.P.K.
Rogovë I, Komuna Gjakovë



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR THERTOREN DHE
MISHTOREN NGA KOMPANIA “ERONA COMPANY” NE FSHATIN ROGOVË 1 –
KOMUNA GJAKOVË

Dhjetor, 2025

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR THERTOREN DHE MISHTOREN
NGA KOMPANIA “ERONA COMPANY” NE FSHATIN ROGOVË 1 – KOMUNA
GJAKOVË

Ngastra me nr. 01070-0, Zona kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës

	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Bashkim Morina, Pronar, Person i Autorizuar
Investitori:	“ERONA COMPANY” SH.P.K. Pronarët: Bashkim Morina
Adresa:	Rogovë, Komuna e Gjakovës
Lokacioni i Fabrikës	Rruga Shefki Thaqi , pn
Tel:	+383 44 133 969
Email:	bashkim.morina11@gmail.com

Investitori:

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

“ERONA COMPANY” SH.P.K.

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Dhjetor, 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË	3
a)	Vendndodhja e Fabrikës	3
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	6
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	7
d)	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	8
e)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit.....	10
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	12
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT.....	13
5.1.	Ndotja e Ajrit.....	13
5.2.	Kushtet dhe karakteristikat klimatike	14
5.3.	Ndotja e ujit	14
5.4.	Temperaturat e Ajrit.....	15
5.5.	Hidrografia në komunën e Gjakovës	15
5.6.	Flora dhe Fauna.....	16
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	18
6.1.	Ndikimet në ajër.....	18
6.2.	Ndikimet në tokë	18
6.3.	Ndikimet në ujë.....	19
6.4.	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	19
6.5.	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	19
6.6.	Ndikimet nga zhurma.....	20
6.7.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	20
6.8.	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat.....	20
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	21
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE.....	22

9.	PERSHKRIMI I MASAVE	24
9.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	24
9.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë.....	24
9.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë.....	25
9.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma.....	25
9.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	25
9.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	26
9.7.	Masat për menaxhimin e mbeturinave	26
1.1	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktjnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve.....	27
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	28
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	28
12.	PËRFUNDIM	30
13.	FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE.....	31
14.	LITERATURA E PERDORUR.....	32

Lista e Figurave

Figura 1.	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë	3
Figura 2.	Raporti i distancës ndërmjet kompanisë me shtëpitë e banimit	4
Figura 3.	Distanca e kompanisë me zonat e mbrojtura natyrore.....	4
Figura 4.	Distanca e kompanisë me lumin Drini i Bardhë	5
Figura 5.	Distanca e kompanisë me qytetin e Gjakovës	5
Figura 6.	Makineria për therrjen e kafshëve.....	8
Figura 7.	Vendi i heqjes së mishit nga kockat.....	9
Figura 8.	Frigorifer për ruajtjen e mishit.....	9
Figura 9.	Disa nga produktet.....	10
Figura 10.	Rrjeti Hidrografik i komunës së Gjakovës	16

Lista e Tabelave:

Tabela 1.	Paraqitje e mbeturinave sipas katalogut shtetëror	26
-----------	---	----

1. HYRJE

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar me qëllim të identifikimit, vlerësimit dhe propozimit të masave mbrojtëse për ndikimet potenciale që dalin nga veprimtaria e thertores dhe mishtores, të operuara nga subjekti ekonomik “ERONA COMPANY” Sh.P.K. Objekti është i ndërtuar dhe funksional, i lokalizuar në parcelat kadastrale nr. 01070-0, në zonën kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës.

Ky raport përbën një komponent thelbësor në procesin e pajisjes me Pëlqim Mjedisor, sipas kërkesave të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke qenë dokumenti bazë për legalizimin dhe vazhdimin e operimit të aktivitetit në përputhje me kornizën ligjore mjedisore.

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë në mënyrë të qartë, të argumentuar dhe transparente ndikimet që mund të rezultojnë nga aktiviteti i therjes së kafshëve dhe përpunimit të mishit, përfshirë edhe veprimtaritë ndihmëse si:

- therjen e kafshëve;
- përpunimin dhe konservimin e mishit;
- si dhe veprimtaritë ndihmëse si transporti, ruajtja, trajtimi i mbetjeve dhe deponimi i nënprodukteve.

Analiza e ndikimeve është realizuar mbi bazën e gjendjes ekzistuese në terren, karakteristikave fizike dhe mjedisore të lokacionit, si dhe dokumentacionit teknik dhe ndërtimor të objektit.

Ky raport ka për detyrë që:

- të identifikojë burimet potenciale të ndotjes gjatë operimit;
- të vlerësojë ndikimet e tyre mbi komponentët e mjedisit si: ajri, uji, toka, biodiversiteti, zhurma dhe peizazhi;
- si dhe të propozojë masa të përshtatshme mbrojtëse për eliminimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative, duke siguruar përputhje me standardet ligjore dhe ekologjike.

Rezultatet e këtij vlerësimi do të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimit administrativ për Pëlqimin Mjedisor, pasi kjo është hera e parë që realizohet vlerësimi mjedisor për këtë aktivitet dhe objekt.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e thertoren dhe mishtoren, me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1, pika 7 dhe shtojca 4 e këtij ligji.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje te tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060,
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr.03/L-106

Udhëzimet administrative:

- Udhëzim Administrativ (Mmph) Nr.04/2025 për Pëmbajtjen, Metodologjinë dhe Përputhshmërinë e Raportit me Kërkesat Ligjore , Praktikat e Zbatueshme dhe Aspektet e Tjera Teknike Të Raportit
- UA (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor,
- Udhëzim Administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.

Pasi që për këtë veprimtari përdoren disa materiale qe hynë tek kategoritë më të rrezikuara për mjedis, atëherë është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. PËR KOMPANINË

“ERONA COMPANY” Sh.P.K. është një subjekt ekonomik vendas me seli në komunën e Gjakovës, i specializuar në fushën e therjes së kafshëve dhe përpunimit të mishit për konsum. Kompania ka filluar aktivitetin e saj që nga viti 2005, duke zhvilluar për më shumë se një dekadë përvojë të qëndrueshme dhe të orientuar drejt cilësisë në sektorin agro-ushqimor. Gjatë kësaj periudhe, “ERONA COMPANY” SH.P.K. ka ndërtuar një emër të besueshëm në tregun lokal dhe rajonal, përmes ofrimit të produkteve të mishit të freskët dhe të përpunuar që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, si në aspektin e cilësisë, sigurisë ushqimore, ashtu edhe të standardeve higjieno-sanitare. Objekti i thertores dhe mishtores operon në përputhje me praktikatat moderne të përpunimit të mishit, duke respektuar kriteret teknike të ndërtimit dhe funksionimit të ambienteve të kontrolluara për ruajtjen e higjienës dhe cilësisë së produkteve. Kompania është e pajisur me pajisje teknologjike dhe infrastrukturore adekuate që mbështesin procesin e therjes, prerjes, përpunimit dhe konservimit të mishit.

a) Vendndodhja e Fabrikës

Fabrika e thertores dhe përpunimit të mishit e kompanisë “ERONA COMPANY” Sh.P.K. është e vendosur në zonën kadastrale Rogovë I, në territorin administrativ të komunës së Gjakovës. Objekti është ndërtuar mbi parcelat kadastrale me numër 01070-0,




Figura 1. Shtirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë

Edhe pse distanca më e afërt ndërmjet fabrikës dhe zonës rezidenciale (shtëpive) është mbi 17.66 metra, veprimtaria zhvillohet tërësisht brenda hapësirave të mbyllura të objektit dhe

vetëm gjatë orarit të punës, duke respektuar standardet teknike dhe mjedisore. Kjo kompani vepron që nga viti 2005 dhe deri tash nuk ka pasur asnjë ankesë nga banoret përreth. Si rezultat, nuk pritet të ketë ndikime të drejtpërdrejta apo të theksuara negative mbi popullatën përreth.




Figura 2. Raporti i distancës ndërmjet kompanisë me shtëpitë e banimit

Në afërsi të kompanisë “ERONA COMPANY” Sh.P.K. nuk gjendet asnjë zonë e mbrojtur me status të veçantë natyror. Megjithatë, në një distancë prej rreth 3.78 kilometrash ndodhet Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë, i cili paraqet një formacion gjeologjik dhe natyror me vlera të veçanta peizazhore dhe turistike. Pavarësisht afërsisë relative, aktivitetet e planifikuara nga kompania nuk pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë apo të rëndësishëm në këtë zonë të mbrojtur, për shkak të distancës gjeografike dhe karakterit të mbyllur të procesit të prodhimit. Fabrika ndodhet në një distancë prej 332.03 metrash nga lumi Drini i Bardhë, duke respektuar distancën e kërkuar sipas kriterëve të mbrojtjes së burimeve ujore dhe duke minimizuar rrezikun për ndikime të mundshme në cilësinë e ujit apo ekosistemin përreth.




Figura 3. Distanca e kompanisë me zonat e mbrojtura natyrore




Figura 4. Distanca e kompanisë me lumin Drini i Bardhë

Kompania është e pozicionuar në një distancë prej rreth 15.2 kilometrash nga qendra urbane e qytetit të Gjakovës, çka nënkupton se aktiviteti industrial zhvillohet jashtë zonës së banuar intensive, duke reduktuar potencialin për ndikime të drejtpërdrejta në ambientin urban dhe në mirëqenien e popullatës lokale.




Figura 5. Distanca e kompanisë me qytetin e Gjakovës

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Objekti i ndërtuar i thertoresh dhe mishtoresh i kompanisë “ERONA COMPANY” Sh.P.K. përfshin një kompleks të integruar i cili është funksional dhe përfshin të gjitha hapësirat dhe komponentët e nevojshëm për thërrjen, përpunimin dhe konservimin e mishit. Veçoritë fizike të këtij projekti janë si më poshtë:

1. Sipërfaqja dhe lokacioni:

- Objekti është i ndërtuar në parcelat kadastrale nr.01070-0, në zonën kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës.
- Sipërfaqja totale e truallit në shfrytëzim është rreth **419 m²**, ku janë ndërtuar objekti kryesor dhe infrastrukturat ndihmëse.

2. Objekti kryesor:

- Ndërtesa përbëhet nga një strukturë ndërtimore me konstruksion të qëndrueshëm me mure prej bllokave të argjilës ndërsa muret e thertoresh janë nga panel senwich, e përshtatur për ruajtjen e kushteve higjieno-sanitare dhe kulmet janë të ndërtuar nga konstruksion çeliku.
- Objekti përfshin këto njësi funksionale:
 - Salla e pranimi të kafshëve;
 - Dhoma e thërjes;
 - Zona e prerjes dhe përpunimit të mishit;
 - Dhoma e konservimit dhe frigoriferët;
 - Depoja për ruajtjen e produkteve dhe mbështjellësve;
 - Hapësira për personelin (gardëroba, sanitare, zyrat administrative).

3. Infrastruktura përcjellëse:

- Objekti ka sistem për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe nënprodukteve nga thërja (si organet e brendshme, kockat, lëkura, etj.), të cilat ruhen në enë të dedikuara dhe transportohen nga operatorë të licencuar.
- Ka sistem ventilimi dhe ndriçimi artificial që siguron kushte të përshtatshme për punë dhe ruajtjen e produkteve.
- Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti publik, ndërsa për nevojat e vazhdueshme operimi.
- Uji për përdorim teknologjik dhe sanitar sigurohet nga pusi i hapur.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit përfshin të gjitha aktivitetet që zhvillohen pas përfundimit të ndërtimit dhe vënies në funksion të thertores dhe mishtores. Kjo fazë karakterizohet nga implementimi i të gjitha proceseve teknike dhe funksionale të nevojshme për operimin efikas dhe në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe mjedisore.

Veçoritë kryesore të kësaj faze përfshijnë:

- **Furnizimin me lende te pare:** kompania furnizohet me krerë lopë nga fermat e ndryshme të vendit.
- **Kapaciteti:** Gjatë një jave, në thertore theren mesatarisht deri në 6 krerë lopë.
- **Pranimi dhe kontrolli i kafshëve:** Në fillim të procesit operativ, kryhet pranimi i kafshëve të gjalla dhe kontrolli veterinar para therjes, në përputhje me ligjet dhe rregulloret për sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve.
- **Procesi i therjes:** Therja do të realizohet brenda hapësirave të mbyllura të objektit, në kushte të kontrolluara, duke respektuar standardet për mbrojtjen e kafshëve dhe kërkesat higjienike të parashikuara me legjislacionin në fuqi.
- **Përpunimi dhe ruajtja e mishit:** Pas therjes, mishi do të përpunohet, klasifikohet, dhe do të magazinohet në dhoma të posaçme frigoriferike me qëllim ruajtjen e freskisë dhe sigurisë së produktit deri në distribuim.
- **Menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura:** Mbetjet organike dhe nënproduktet e tjera do të menaxhohen në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar, përmes kontraktimit të operatorëve të licencuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, për të shmangur ndotjen mjedisore. Ndërsa ujerat e ndotura shkarkohen në grope septike të cilat para trajtimit, para se të shkarkohen në kanalizimin e fshatit.
- **Orari i punës:** Aktivitetet do të zhvillohen gjatë orarit të rregullt të punës ditore, pa operime gjatë natës, çka ndihmon në minimizimin e ndikimeve si zhurma apo shqetësimet për komunitetin lokal.
- **Siguria dhe higjiena në punë:** Gjithë operimi do të zhvillohet sipas standardeve të sigurisë dhe higjienës në vendin e punës, për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve dhe për të garantuar cilësinë e produkteve të mishit.

Faza operative e projektit është projektuar për të qenë funksionale, efikase dhe në përputhje të plotë me kërkesat teknike dhe mjedisore, duke siguruar një ndikim sa më të vogël në mjedis dhe në popullatën përreth.

d) Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Procesi teknologjik në objektin e thertores dhe mishtores të kompanisë “ERONA COMPANY” Sh.P.K. zhvillohet në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Objekti është i pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e të gjitha fazave të therjes, përpunimit dhe ruajtjes së mishit, përfshirë edhe shitjen e tij në mishtoren e brendshme të kompanisë.

- **Pranimi dhe Kontrolli i Kafshëve** – Kafshët të cilat sigurohen nga fermat e ndryshme te vendit, pranohen në ambientet përkatëse dhe kontrollohen nga veterineri zyrtar përpara therjes, për të siguruar që janë të shëndetshme dhe të përshtatshme për konsum.
- **Therja dhe Gjakderdhja** - Therja realizohet brenda objektit të thertores, në hapësira të dedikuara dhe të pajisura sipas kritereve ligjore. Gjatë një jave, në thertore theren mesatarisht deri në 6 krerë lopë. Gjakderdhja e kafshëve ndodh në mënyrë të kontrolluar, ku gjaku rrjedh përmes sistemit të mbyllur të tubacioneve drejt një grope septike, ndërtuar me standarde për menaxhimin higjienik të mbetjeve të lëngshme organike. Kjo parandalon derdhjen në ambient dhe ndotjen e ujërave ose tokës.



Figura 6. Makineria për therjen e kafshëve

- **Heqja e Lëkurës dhe organeve të brendshme** - Pas gjakderdhjes, realizohet heqja e lëkurës. Kafsha shpëlahet, dhe më pas hapet për të nxjerrë organet e brendshme. Organet e përshtatshme për konsum ndahen dhe ruhen në dhoma të ftohta, ndërsa ato të papërshtatshme grumbullohen në enë të veçanta dhe dorëzohen tek operatorë të licencuar për mbetje shtazore.



Figura 7. Vendi i heqjes së mishit nga kockat

- **Inspektimi Pas-Therjes** - Veterineri zyrtar kryen kontrollin post-mortem për të garantuar sigurinë ushqimore. Vetëm produktet që kalojnë këtë kontroll lejohen të hyjnë në fazat e mëtejshme të përpunimit.
- **Prerja dhe Përpunimi** – pas prerjes së lopëve transferohen në hapësirat e përpunimit ku priten në pjesë më të vogla, sipas kërkesave të tregut (fileto, kofshë, mish i bluar, etj.). Prerja kryhet në tavolina, të cilat dezinfektohen pas çdo përdorimi për të ruajtur sigurinë ushqimore.
- **Ruajtja e mishit** - Mishi ruhet në dhoma frigoriferike me temperaturë të kontrolluar deri në momentin e shitjes. Dhoma frigoriferike është e pajisur me sistem monitorimi të temperaturës dhe alarm për devijime, duke siguruar që zinxhiri i ftohtë të mos ndërpritet.



Figura 8. Frigorifer për ruajtjen e mishit

- **Shitja në mishtore** - Në pjesën e përparme të objektit funksionon mishtorja, ku mishi i përpunuar shitet direkt për konsumatorët. Kjo lejon shitje të mishit të freskët në afat optimal, me te dhënat e identifikuara si: prej nga ka ardhë mishi, ku dhe kur është pakëtuar, te dhënat e kompanisë.




Figura 9. Disa nga produktet

e) **Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit**

Gjatë fazës së operimit të objektit të thertores dhe mishtores, parashikohet gjenerimi i mbetjeve të ndryshme të ndara sipas kategorive funksionale dhe ndikimit potencial mjedisor. Më poshtë paraqitet klasifikimi dhe përlllogaritja e përafërt e sasisë së mbetjeve dhe emetimeve:

- **Mbetjet organike nga therja e kafshëve** - Llojet kryesore të mbetjeve organike përfshijnë:
 - Gjaku,
 - Organe të padobishme për konsum (mëlçi e dëmtuar, etj.),
 - Lëkura (nëse nuk riciklohen),
 - Kocka të tepërta,
 - Lëndë të patretshme ushqimore në zorrë.

Përlllogaritje e përafërt për 6 lopë në javë (rreth 24 lopë në muaj):

- **Gjaku:** ~15 litra për lopë → $15 \text{ L} \times 24 = 360 \text{ litra/muaj}$
- **Organe dhe pjesë të brendshme të padobishme:** ~30 kg/krerë → $30 \times 24 = 720 \text{ kg/muaj}$
- **Kocka të tepërta:** ~40 kg/krerë → $40 \times 24 = 960 \text{ kg/muaj}$
- **Lëkurë:** ~30 kg/krerë → $30 \times 24 = 720 \text{ kg/muaj}$

Këto mbetje ruhen përkohësisht në kontejnerë të dedikuar frigoriferik dhe pastaj transportohen nga operator të licencuar për mbetje.

- **Ujëra të ndotura**

Gjatë larjes së trupave të kafshëve, pastrimit të pajisjeve dhe ambientit, krijohen ujëra të ndotura me ngarkesë organike. Këto ujëra derdhen në sistemin e kanalizimit të brendshëm dhe më pas në gropën septike, ujërat e zeza trajtohen paraprakisht në mënyrë natyrale në gropën septike me ndarje të ngurtësiravë.

- **Mbetje të ngurta komunale** - Ambalazhe, letër, mbështjellës plastikë, mbeturina nga stafit.

Sasia e përlogaritur mujore:

- Rreth **50 – 70 kg/muaj**, të cilat klasifikohen si mbetje komunale dhe mblidhen nga shërbimi komunal i Komunës së Gjakovës.
- **Emisionet në ajër** - Nuk priten emisione të konsiderueshme industriale në ajër. Aktivitetet përpunuese nuk përfshijnë djegie industriale apo procese të tjera që lëshojnë gazra në atmosferë. Emisionet e vetme të mundshme janë nga automjetet transportuese (emetime indirekte CO₂).
- **Zhurma dhe ndotja akustike** - Niveli i zhurmës gjatë operimit është i ulët dhe periodik, e vetmja zhurmë e cila mund të shkaktohet është momenti i përdorimit të pistolës , e cila përdoret për alivanosje të kafshëve, zhurma tjetër mund të shkaktohet me funksionimin e pajisjeve elektrike dhe automjeteve. Nuk parashikohet tejkalim i pragjeve të lejuara ligjore për zhurmën, pasi aktiviteti zhvillohet në zonë rurale dhe në ndërtesë të mbyllur.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Zgjedhja e lokacionit aktual për ndërtimin dhe operimin e thertoresh dhe objektit për përpunimin e mishit nga kompania “ERONA COMPANY” Sh.P.K. është rezultat i një analize të kujdesshme të alternativave të mundshme, duke u bazuar në kritere funksionale, ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Lokacioni i përzgjedhur ka qenë më parë vend i një veprimtarie familjare, e cila ka krijuar një infrastrukturë fillestare dhe një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e mëtejshëm të një aktiviteti industrial të kontrolluar. Kjo gjendje ekzistuese ka ndikuar që ky lokacion të konsiderohet si alternativa më e arsyeshme për realizimin e projektit.

Arsyet kryesore që e bëjnë këtë lokacion të favorshëm përfshijnë:

- **Përdorimi paraprak i hapësirës:** Kjo zonë ka qenë e shfrytëzuar më parë për qëllime biznesi familjar, gjë që ndihmon në shmangien e ndërhyrjeve të mëdha në mjedis dhe mbështet përshtatshmërinë e saj për qëllime industriale.
- **Veprimtaria zhvillohet brenda objektit:** Të gjitha proceset operationale të thertoresh dhe përpunimit të mishit do të zhvillohen brenda ambienteve të mbyllura, të cilat janë projektuar në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore. Kjo qasje redukton ndjeshëm ndikimin e mundshëm në popullatën përreth, sidomos sa i përket zhurmës, erërave dhe ndotjes vizuale.
- **Distancimi nga zona urbane:** Lokacioni ndodhet në një distancë të konsiderueshme nga qyteti i Gjakovës dhe zonat urbane rezidenciale, duke minimizuar ndikimet sociale dhe ambientale në komunitetet e banuara.
- **Përfitimi nga infrastruktura ekzistuese:** Zona ofron qasje në rrugë ekzistuese dhe ka mundësi lidhjeje me rrjetet e energjisë dhe ujit, duke shmangur investimet e panevojshme infrastrukturore.

Bazuar në vlerësimin e të gjitha faktorëve të përmendur më lart, alternativa aktuale për lokacionin është më e qëndrueshme, më funksionale dhe më e pranueshme në aspektin mjedisor dhe social, ndërsa alternativat e tjera janë refuzuar për shkak të kostove më të larta të zhvillimit, mungesës së infrastrukturës, apo rrezikut më të madh për ndikime negative në mjedis dhe komunitet.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e përgjithshme mjedisore e Gjakovës nuk dallon shumë nga gjendja e përgjithshme e mjedisit në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo afër zonave industriale. Qasja ende jo e plotë në furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime sanitare, mostrajtimi i ujërave sanitare urbane apo industrial (edhe pse Gjakova është në proces të ndërtimit të kolektorëve kryesorë të ri dhe Impiantit të trajtimit të ujërave të zeza), problemet me menaxhimin e mbeturinave, ndotja ajrit, zhurma, prezenca e antenave të telefonisë mobile, gjelbërimit i pamjaftueshëm në qytet dhe e vende të limituara për pushim e rekreacion, janë disa indikator që tregojnë cilësinë e mjedisit dhe që kërkojnë veprime konkrete për përmirësimin e tyre.

5.1. Ndotja e Ajrit

Gjendja e përgjithshme mjedisore e Gjakovës nuk dallon shumë nga gjendja e përgjithshme e mjedisit në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo afër zonave industriale. Qasja ende jo e plotë në furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime sanitare, mostrajtimi i ujërave sanitare urbane apo industrial (edhe pse Gjakova është në proces të ndërtimit të kolektorëve kryesorë të ri dhe Impiantit të trajtimit të ujërave të zeza), problemet me menaxhimin e mbeturinave, ndotja ajrit, zhurma, prezenca e antenave të telefonisë mobile, gjelbërimit i pamjaftueshëm në qytet dhe e vende të limituara për pushim e rekreacion, janë disa indikator që tregojnë cilësinë e mjedisit dhe që kërkojnë veprime konkrete për përmirësimin e tyre. Qytetin e Gjakovës e karakterizon një trafik mjaftë i dendur, me numër të madh makinash, që brenda ditës që qarkullojnë nëpër qytet. Mungesa e vendeve të mjaftueshme për parkim, makina të vjetra dhe dendësia e qarkullimit drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen e madhe të ajrit dhe ndikim në shëndetin e popullatës. Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit të cilat nuk janë të lidhura me ngrohjen e qytetit e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lendeve tjera djegëse cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Gjithashtu edhe ngrohja e qytetit të Gjakovës si lëndë djegëse përdor naftën që gjithashtu ndikon në ndotjen e ajrit. Mos mbulshmeria e plotë me ngrohje qendrore të qytetit ka shtuar përdorimin e rrymës elektrike dhe lendeve tjera për ngrohje që rëndojnë situatën mjedisore në qytet. Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është ende i kufizuar. Trendi i ndërhyrjeve për përmirësim të izolimeve të objekteve ekzistuese apo objektet e reja të banimit pritet të japin efektet pozitive në zvogëlimin e përdorimit të energjisë për ngrohje. Në territorin e Komunës së Gjakovës nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit andaj në një të ardhme të afërt do duhej të vendosen instrumente monitoruese në disa pika në

qytet. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plot i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes. Burimet kryesore të ndotjes janë: Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërmija të pluhurit, bloza, SO₂ dhe NO_x, si rezultat i trafikut dhe ngrohjes sezonale ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndotjen e ajrit në qytet por edhe në gjithë hapësirën e Komunës së Gjakovës; Lirimi i gazrave serë (CO₂, SO₂, NO_x) nga djegjia e mbeturinave nëpër kontejner apo jashtë tyre dhe aktivitete të operatorëve ekonomik brenda dhe jashtë qytetit, Cilësia e rrugëve dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshme e tyre dhe të parkingjeve që kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit, dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet.

5.2.Kushtet dhe karakteristikat klimatike

Komuna e Gjakovës karakterizohet me një klimë kontinentale me verë të nxehtë dhe me dimër të ftohtë, ku muaji më i nxehtë është muaji Gusht dhe muaji më i ftohtë është muaji Janar. Pozita gjeografike e Gjakovës me rrethinë ka kushtëzuar që në këtë regjion të dominojë klima e mesme kontinentale me një ndikim të klimës mediterane, e cila depërton përmes luginës së Drinit të Bardhë. Në bazë të shënimeve shumë vjeçare klimatike, lokaliteti i Gjakovës karakterizohet me këto veçanti meteorologjike: Temperatura mesatare vjetore është +11.9°C, muaji më i ftohtë i vitit është Janari me temperaturë mesatare -0.1°C, ndërsa muaji më i nxehtë i vitit është Gushti me +22.2°C. Temperatura mesatare gjatë vegjetacionit është +18,6°C ndërsa sasia e reshjeve vjetore 754,8mm por sasia e reshjeve gjatë vegjetacionit është vetëm 342,90mm.

5.3.Ndotja e ujit

Resurset ujore janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Vlerësohet se territori i Komunës së Gjakovës ka rezerva të kufizuara burimeve ujore dhe të njëjtat janë goxha të ndotura. Ndotja e ujerave në territorin e komunës reflektohet kryesisht nga ndotja prej shkarkimeve të ujërave të zeza sanitare dhe ujërave industriale të cilat shkarkohen drejtpërdrejtë në lumenjtë e lartpërmendur apo trupa tjerë ujqor pa ndonjë trajtim paraprak. Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujqor edhe në të ardhmen do të jete burim i ndotjes se ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë si burime të përdorura për nevojat e qytetarëve.

5.4.Temperaturat e Ajrit

Duke u bazuar në pozitën gjeografike dhe klimatike, territori i komunës së Gjakovës karakterizohet me temperatura ekstreme të ulëta gjatë sezonës së dimrit, kështu që dimrat shoqërohen me të reshura relativisht të mëdha të borës për rrethanat kosovare, dhe me temperatura të ulëta deri në -20°C. Reshjet e borës shpesh arrijnë limitin 1. metër/l në qytet, ndërsa në zonat e thella rurale edhe mbi 1 metër. Në qoftë se merret në konsideratë edhe mundësia formimit të akullit, atëherë është evidente bllokimi dhe vështirësimi i qarkullimit rrugor i njerëzve dhe mallrave e në mënyre edhe me të theksuar nëpër fshatrat e zonave të thella siç është zona kufitare rreth fshatrave Prush e Goden në anën e Hasit, apo fsh. Palabardhe, Shqiponje, etj, në zonën e Dushkajës..

5.5.Hidrografia në komunën e Gjakovës

Resurset ujore janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Vlerësohet se territori i Komunës së Gjakovës ka rezerva të kufizuara të burimeve ujore dhe të njëjtat janë goxha të ndotura. Ndotja e ujërave në territorin e komunës reflektohet kryesisht nga ndotja prej shkarkimeve të ujërave të zeza sanitare dhe ujrave industriale të cilat shkarkohen drejtpërdrejtë në lumenjtë e lartpërmendur apo trupa tjerë ujqor pa ndonjë trajtim paraprak. Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujqor edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si burime të përdorura për nevojat e qytetarëve. Lumenjtë dhe rrjedhat tjera ujore në Gjakovë janë pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë, i cili formon kufijtë e Gjakovës me komunën e Rahovecit në lindje. Lumi Ereniku- e ka burimin e tij në Bjeshkët e Nemuna dhe rrjedhë përmes territorit të komunës dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Ndërsa lumenjtë dhe përrenjë të vegjël si: Neci, Trava, Krena dhe Trakaniqi Raça, duke rrjedhur nga veriu në jug, derdhen në lumin Ereniku. Sot shtrati dhe brigjet e lumit janë degraduar nga shfrytëzimi i pa kontrolluar i rrës dhe zhavorrit. Lumi Krena - kalon përmes qytetit dhe shtrati i tij është rregulluar në një gjatësi prej 1400m. Gjendja e lumit deri më tani ka qenë e mjerushme, po që aktualisht kanë përfunduar punimet në një pjesë të tij dhe deri në vitin 2021 pritet të rregullohet në tërësi. Lumi Trakaniq - kalon në pjesën lindore të qytetit dhe shtrati i tij nuk është i rregulluar. Aktualisht gjendja e tij nuk është e kënaqshme jo vetëm përshkak të shkatërrimeve të ndryshme por edhe nga hudhja e mbeturinave në shtrat apo përgjatë tij. Liqeni i Radoniqit - Në Komunën e Gjakovës ekziston edhe Liqeni i Radoniqit i cili ka filluar të mbushet në vitin 1982 nga ish lumi Radoniq dhe Lumbardhi i Deçanit me anë të kanalit derivues me ngritjen e Pendës që gjindet në Llukë të Epërme, dhe është në funksion që nga viti 1985. Kapaciteti maksimal i këtij

Liqeni është rreth 117 milion m³ deri në kuotën mbidetare 456m. Pjesa më e madhe e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor në Gjakovës është e mesme me një sipërfaqe prej 23,027.09 ha apo 39.30 % të territorit, ndërsa sipërfaqja prej 14,532.63 apo 24.80 % e territorit të komunës ka ndjeshmëri shumë të lartë të ujërave nëntokësore.




Figura 10. Rrjeti Hidrografik i komunës së Gjakovës

5.6. Flora dhe Fauna

Flora - në komunën e Gjakovës ka shumëllojshmërisë së botës së gjallë-biodiversitetit, vend me rëndësi padyshim se ka edhe mbulesa bimore apo thënë ndryshe flora dhe vegjetacioni. Sipas ndryshimeve bazuar në lartësinë mbidetare, në shtrirje vertikale të florës dhe vegjetacionit të territorit të komunës së Gjakovës dallojmë disa zona. Këto zona janë të ndryshme varësisht nga pozita gjeografike, përbërja gjeologjike, relievi, madhësia e masivit të caktuar. Në terrene në fragmente të shkëputura e shpesh të vogla si rezultat i veprimit antropogjen rriten lloje bimore të ultësirave të cilat hyjnë në kuadër të vegjetacionit të pyjeve respektivisht shkurreve me shelg e plep por edhe me verr e marinë (brukë) të cilat zhvillohen më tepër përgjatë luginave lumenjëve, ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë klasëve Querco-Fagetea e Alnetea glutinosae, rendeve Alnetalia glutinosae dhe Populetalia albae si dhe alencave Alnion glutinosae, Salicion albae dhe Populion albae. Llojet më të shpeshta bimore të këtyre hapësirave në katin e drurëve janë prezente llojet Salix alba (dominon), Populus nigra, Ulmus effusa, Alnus glutinosa, Salix fragilis. Në katin e shkurreve janë prezente llojet bimore Salix purpurea, Frangula alnus, Cornus sanguinea, Tamarix tetrandra ndërsa në katin e bimëve barishtore gjenden llojet bimore Galium palustre, Alisma plantago aquatica, Veronica anagallis, Mentha aquatica, Agrostis alba. Në hapësira të ultësirave pjesë të konsiderueshme u takojnë livadheve të ultësirave të cilat në aspektin sintaksonomik i takojnë aleancës Trifolion resupinati, rendit Trifolio-Hordetalia dhe klasës Molinio-Arrhenatheretea (Hundozi, B, 1980, Rexhepi, F.

1982, 1994, 2007, Krasnqi, E. 2003, 2006, Kastrati, A. 2015). Në këto livadhe janë prezente llojet bimore karakteristike për livadhet e ultësirave.

Fauna - ne komunën e Gjakovës ka një faunë mjaft të pasur me një numër të madh organizmave të renditura si me poshtë. Ichtiofauna e Gjakoves: *Eudontomyzon stankokaramani* Karaman, *Rhodeus meridionalis* Karaman, *Phoxinus phoxinus*, *Barbus barbus*, *Alburnoides bipunctatus*, *Squalicus cephalus*, *Leuciscus leuciscus*, *Leucaspius delineatus*, *Barbus rebeli*, *Chondrostoma nasus*, *Cyprinus carpio*, *Carassius gibelio*, *Scardinius erythrophthalmus*, *Ctenopharyngodon idella*, *Gobio gobio*, *Pseudorasbora parva*, *Alburnus alburnus*, *Rutilus rutilus*, *Cobitis ohridana* Karaman, *Sabanejevia balcanica*, *Cottus gobio* Linnaeus, *Perca fluviatilis*, *Salmo trutta* Linnaeus. Ujëtokësorët me bisht - Caudata: *Salamandra atra*, *Salamandra maculosa*, *Triturus vulgaris*, *Triturus alpestris*,. Ujëtokësorët pa bisht -Eucaudata: *Rana ridibunda*, *Rana graeca*, *Rana dalmatina*, *Rana temporaria*, *Bufo vulgaris*, *Bufo viridis*,. Reptilia ose rrëshqitësit: *Vipera ammodytes*, *Natrix natrix*, *Natrix tessellata*, *Dolichophis caspius*, *Coronella austriaca*, *Zamenis longissimus*, *Testudo hermanni*, *Algyroides nigropunctatus*, *Emys orbicularis*, *Podarcis muralis*, *Lacerta agilis*, *Lacerta viridis*, *Anguis fragilis*, *Podarcis tauricus*. Shpezët: Regjioni i Gjakovës është poashtu i pasur me një shumëllojshmëri të shpezëve (mbi 150 lloje) ku pjesën më të madhe e dominojnë shpezët këngëtare (familja Corvidae, Paridae , Motacillidae, Turdidae, Sylvidae, Lanidae, Hirundinidae, Columbidae), pastaj grabitësit e vërtetë të sistemtizuar në rendin Falconiformes me familjet Aqualidae dhe Falconidae. Disa prej shpezëve janë të përhershme (harabelat, pëllumbi i egër, kumria, pikthat, kukuvajka, huti, përfaqësues të familjes corvidae). Disa prej tyre vijnë gjatë verës (Mars-Prill dhe qëndrojnë deri në shtator- tetor, e disa tjera vijnë në vjeshtë dhe qëndrojnë deri në pranverë ose disa tjera që shihen kalimthi dhe mund të shihen ose në pranverë apo edhe në vjeshtë. Disa shpezë ndonjëherë mund të jenë të dëmshme duke u ushqyer me fara dhe frute të ndryshme të pemëve, me fara dhe frute të drithërave duke ju shkaktuar dëme të mbjellurave dhe kopshtijeve, pastaj me vezë dhe të vegjël të shpezëve shtëpiake, por në të njëjtën kohë të njëjtat shpezë me sukses i shfarosin shumë larva dhe vezë insektesh të cilat i shkaktojnë dëme mjaft të mëdha pemëve dhe kulturave tjera bujqësore, disa prej tyre ushqehen me brejtës të vegjël të cilët poashtu i shkaktojnë dëme të mëdha të lashtave bujqësore. Pra në këtë rast dobia është më e madhe se dëmi i tyre prandaj duhet edhe të kujdesemi për to. Gjitarët (Mammalia): *Vulpes vulpes*, *Canis lupus*, *Ursus arctos*, *Sciurus vulgaris*, *Mustela nivalis*, *Lutra lutra*, *Lepus europaeus*, *Mustela putorius*, *Martes martes*, *Capreolus capreolus*, *Meles meles*, *Mustela erminea*, *Sus scrofa*, *Talpa caeca*, *Erinaceus roumanicus*, *Canis aureus*, *Felis silvestris*, *Vespertilinidae*.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Investimi në thertoren dhe mishtoren, përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në sektorin ndërtimor në rajon, duke ofruar produkte të nevojshme për infrastrukturë dhe njëkohësisht duke krijuar mundësi të reja punësimi në Komunën e Gjakovës. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, në këtë kapitull paraqitet një shqyrtim i detajuar i ndikimeve mjedisore të këtij aktiviteti, duke përfshirë edhe masat zbutëse që do të ndërmerren për të eliminuar apo minimizuar këto ndikime.

Analiza e VNM-së në këtë rast është zhvilluar në përputhje me dokumentacionin teknik të projektit dhe gjendjen reale në terren, respektivisht në zonat kadastrale Rogovë I, ku objekti është ndërtuar dhe operon aktualisht. Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë ndikimin që ky aktivitet ka mbi mjedisin, në funksion të ruajtjes së një zhvillimi të qëndrueshëm, duke mos cenuar integritetin ekologjik dhe shëndetin e komunitetit lokal.

Në vlerësimin e ndikimeve janë marrë parasysh aspektet:

- **Kimike-fizike**, si ndotja e ajrit, ujit dhe tokës;
- **Biologjike-ekologjike**, që përfshijnë ndikimin mbi biodiversitetin dhe ekosistemet lokale;
- **Socio-ekonomike**, që lidhen me ndikimet pozitive apo negative në komunitetin përreth, përfshirë cilësinë e jetës, punësimin dhe peizazhin vizual.

Për secilin nga këta komponentë janë identifikuar ndikimet potenciale si dhe janë propozuar masa të përshtatshme për të garantuar që operimi i fabrikës të jetë në përputhje me standardet mjedisore dhe në dobi të shoqërisë dhe natyrës.

6.1.Ndikimet në ajër

Gjatë fazës operative të thertores dhe mishtores në zonën kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës, priten disa ndikime të kufizuara në cilësinë e ajrit, të cilat lidhen kryesisht me emetimin e aromave të pakëndshme që vijnë nga aktivitetet e therjes, përpunimit dhe ruajtjes së përkohshme të mbetjeve organike. Përveç kësaj, përdorimi i automjeteve për transportin e kafshëve të gjalla dhe produkteve të mishit mund të kontribuojë në emisione të vogla të gazrave djegës dhe grimcave PM, por në një shkallë shumë të kufizuar për shkak të frekuencës së ulët të qarkullimit dhe volumit të vogël të aktivitetit.

6.2.Ndikimet në tokë

Proceset operative të thertores dhe mishtores mund të ndikojnë në mjedisin tokësor përmes kontaktit të mundshëm me mbetje organike dhe mbetje të ngurta që krijohen gjatë therjes, përpunimit dhe pastrimit të hapësirave të punës. Megjithatë, duke qenë se sistemi i trajtimit të

lëngjeve është i mbyllur dhe i drejtuar në një gropë septike, rreziku i infiltrimit të drejtpërdrejtë në tokë është i minimizuar në mënyrë të ndjeshme. Mbetjet e ngurta që gjenerohen nga aktiviteti përpunohen në mënyrë të kontrolluar dhe dërgohen për menaxhim nga kompani të licencuara, çka ndihmon në shmangien e ndotjes së shtresave të sipërme të tokës. Gjithashtu, mirëmbajtja periodike e ambientit të punës dhe pastrimi i rregullt i sipërfaqeve operative redukton rrezikun nga shpërndarja aksidentale e materialeve ndotëse në tokë. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në masat teknike të zbatuara dhe praktikën e menaxhimit mjedisor, ndikimi në tokë vlerësohet si minimal dhe lehtësisht i kontrollueshëm, pa pasoja të konsiderueshme mbi cilësinë e mjedisit tokësor përreth objektit.

6.3.Ndikimet në ujë

Gjatë fazës operative të thertores dhe mishtores, ndikimet potenciale në mjedisin ujor lidhen kryesisht me menaxhimin e ujërave të ndotura që gjenerohen nga proceset e pastrimit, therjes dhe përpunimit të mishit. Megjithatë, objekti është i pajisur me një sistem të mbyllur të kanalizimit, ku ujërat dhe lëngjet organike, përfshirë gjakun, derdhen në mënyrë të kontrolluar përmes tubacioneve të dedikuara drejt një grope septike të ndërtuar sipas standardeve teknike dhe higjieno-sanitare. Kjo masë ndihmon në shmangien e derdhjeve të pakontrolluara dhe minimizon rrezikun e ndotjes së ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore. Gjithashtu, mungesa e burimeve ujore të afërta me objektin redukton më tej mundësinë e ndikimeve të drejtpërdrejta në ekosistemet ujore. Rrjedhimisht, falë infrastrukturës ekzistuese për menaxhimin e ujërave të ndotura dhe zbatimit të praktikave të sigurta të operimit, ndikimi në komponentin ujor vlerësohet si i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.4.Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ndikimet në peizazh janë minimale, pasi nuk kryhen punime të mëdha ndërtimore apo modifikime të dukshme të terrenit gjatë fazës operative. Sa i përket florës dhe faunës, zona ku ndodhet objekti nuk përbën habitat natyror të veçantë apo zonë të mbrojtur, dhe aktivitetet e zhvilluara nuk shkaktojnë dëmtime drektë apo fragmentim të habitateve. Menaxhimi adekuat i mbetjeve dhe kontrolli i emisioneve të mundshme ndihmon në parandalimin e përkeqësimit të kushteve për organizmat lokalë. Për më tepër, nuk ka raportime të ndikimeve negative të rëndësishme mbi biodiversitetin apo popullatat e kafshëve në afërsi të objektit.

6.5.Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Veprimtaria e thertores dhe mishtores në zonën kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës, ndikon drejtpërdrejt në komunitetin lokal dhe popullatën përreth. Në përgjithësi, ndikimet socio-ekonomike janë pozitive, pasi investimi krijon vende pune dhe kontribuon në zhvillimin

ekonomik të rajonit. Përmes masave të marra për kontrollin e emetimeve dhe përpunimin adekuat të mbetjeve, ndikimet negative në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve minimizohen. Gjithashtu, infrastruktura e ndërtuar për trajtimin e ujërave të ndotura (gropa septike) dhe përpunimin e mbetjeve siguron shmangien e ndotjes së mjedisit dhe përmirëson kushtet higjieno-sanitare në zonë.

6.6.Ndikimet nga zhurma

Objekti i thertores dhe mishtores nuk gjeneron zhurma të konsiderueshme gjatë procesit të punës, pasi aktivitetet që zhvillohen brenda objektit, si therja dhe përpunimi i mishit, realizohen me pajisje që nuk prodhojnë nivele të larta të zhurmës. E vetmja burim potencial i zhurmës lidhet me përdorimin e pistoles dhe mjetet e transportit që hyjnë dhe dalin nga objekti për qëllime të furnizimit dhe shpërndarjes së produkteve.

6.7.Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Në rastet e mundshme të aksidenteve mjedisore, si rrjedhje aksidentale të lëngjeve organike apo derdhje të mbetjeve të ngurta nga procesi i therjes, mund të ndodhin ndotje të përkohshme të tokës apo ujërave nëntokësore nëse nuk merren masa të menjëhershme. Megjithatë, objekti është i pajisur me gropë septike për trajtimin e ujërave të ndotura, duke përfshirë edhe rrjedhjet e gjakut nga therja, çka redukton rrezikun e ndotjeve të jashtme. Po ashtu, mbetjet e ngurta ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të kontrolluar deri në grumbullimin dhe largimin e tyre nga operatorë të licencuar. Stafit është i trajnuar për menaxhimin e situatave emergjente dhe zbatimin e protokolleve për kontrollin e ndotjeve, duke minimizuar ndikimin e mundshëm të aksidenteve në mjedis dhe shëndetin publik. Për më tepër, respektimi i standardeve higjieno-sanitare dhe kontrollet periodike kontribuojnë në parandalimin e ngjarjeve të tilla.

6.8.Ndikimi mjedisor nga mbeturinat

Gjatë operimit të objektit për therjen dhe përpunimin e mishit, krijohen disa lloje mbeturinash, përfshirë mbeturinat organike nga procesi i therjes (si pjesët e padobishme të kafshëve), mbeturinat e ngurta komunale (ambalazhe, mbetje ushqimore të stafit) si dhe mbetje të pakta të materialeve higjienike. Mbetjet organike menaxhohen në mënyrë të kontrolluar përmes kontratave me kompani të licencuara për grumbullimin dhe trajtimin e tyre, duke parandaluar shpërndarjen në mjedis dhe ndotjen e tokës ose ujit. Mbetjet komunale grumbullohen në kontejnerë të dedikuar dhe dërgohen për trajtim në sistemin komunal të menaxhimit të mbeturinave.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundshme që mund të paraqiten gjatë operimit të thertoresh dhe mishtores për shitjen e mishit nga kompania në parcelat 01070-0, zona kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës, janë të lidhura me aktivitetet e therjes, përpunimit, menaxhimit të mbeturinave organike dhe lëvizjes së mjeteve transportuese. Edhe pse objekti tashmë është ndërtuar dhe aktiviteti zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike, disa ndikime potenciale në mjedis mbeten të mundshme, të cilat përmbledhen më poshtë:

Ndikimet në ajër - Gjatë fazës së operimit, ndikimet në ajër janë minimale dhe kryesisht lidhen me lëvizjen e mjeteve transportuese që sjellin kafshët për therje dhe shpërndajnë produktet e përpunuara të mishit. Emisionet kryesore janë të lidhura me gazrat e shkarkuar nga motorët (CO_2 , NO_x), por këto janë të përkohshme dhe të menaxhueshme përmes mirëmbajtjes së rregullt të mjeteve dhe organizimit të transportit në mënyrë efikase.

Ndikimet në tokë - Aktivitetet e therjes dhe përpunimit kryhen në hapësira të mbyllura dhe të betonizuara, duke minimizuar kontaktin me tokën natyrore. Gjaku dhe lëngjet e tjera organike transportohen përmes tubacioneve të mbyllura në një gropë septike, duke shmangur derdhjen e tyre në sipërfaqe. Rrjedhjet eventuale nga makineritë ose mjete transportuese janë të kufizuara dhe mund të evitohen me sisteme kontrolli dhe pastrimi të rregullt.

Ndikimet në ujë - Sistemi i kanalizimit është i mbyllur, ku uji i ndotur organik (si gjaku) grumbullohet në gropën septike. Nuk ka derdhje të ujërave të ndotura në rrjete ujore ose në ujërat nëntokësore. Në këtë mënyrë, ndikimet në cilësinë e ujërave vlerësohen si të papërfillshme, për sa kohë groja septike menaxhohet sipas rregulloreve për trajtimin e ujërave të ndotura.

Ndikimet në peizazh dhe ekosisteme - Objekti është i integruar në zonën rurale ku është ndërtuar, pa ndërhyrje në zona të ndjeshme ekologjike. Meqë aktiviteti zhvillohet brenda hapësirës ekzistuese dhe pa zgjerim në ambientin natyror përreth, ndikimi në florën dhe faunën lokale është minimal.

Ndikimet në vendbanime dhe popullatë - Thertorja dhe mishtorja ndodhen larg zonave të dendura banimi, çka kufizon ndikimin e ndotjeve si erërat, zhurmat apo aktiviteti i mjeteve të transportit mbi popullatën. Produktet e mishit tregtohen në vendin e ngjarjes, duke kufizuar nevojën për qarkullim të shpeshtë. Ndikimet në cilësinë e jetës së banorëve janë të papërfillshme për sa kohë respektohen masat higjieno-sanitare dhe orari i punës.

Ndikimet nga zhurma - Zhurma e vetme që mund të krijohet është ajo që lidhet me përdorimin e pistoles para therjes së kafshëve, lëvizjen e mjeteve transportuese dhe aktivitetet ndihmëse

logjistike. Pajisjet dhe aktivitetet brenda thertores nuk krijojnë zhurmë të lartë, dhe për këtë arsye ndikimi në mjedisin akustik është i kufizuar dhe jo shqetësues për komunitetin përreth. Operimi i thertores dhe mishtores ka ndikime të menaxhueshme në mjedis, të cilat mund të mbahen brenda kufijve të lejuar ligjor përmes zbatimit të masave teknike, sanitare dhe monitoruese të përshtatshme.

8. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai, ku ne rastin tone do ti vlerësojmë vetëm gjatë operimit pasi që tashme objekti është i ndërtuar dhe kompania edhe ne zhvillim të veprimtarisë. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.

- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhisë së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhisë së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE

Në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe garantimit të zhvillimit të qëndrueshëm, identifikimi i ndikimeve potenciale nga aktivitetet e thertores dhe mishtores shoqërohet me domosdoshmërinë për të përcaktuar masa të qarta për minimizimin apo eliminimin e këtyre ndikimeve. Megjithëse objekti i kompanisë “ERONA COMPANY” Sh.P.K. është tashmë i ndërtuar dhe operon në përputhje me kriteret teknike dhe ligjore, vendosja e masave parandaluese dhe korrigjuese paraqet një hap të rëndësishëm për mbajtjen e ndikimeve brenda kufijve të lejuar. Masat e propozuara më poshtë janë hartuar në bazë të analizës së ndikimeve të konstatuara në komponentët kryesorë mjedisorë (ajër, tokë, ujë, peizazh, biodiversitet dhe komunitet), dhe synojnë të garantojnë mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e cilësisë së jetesës në zonën përreth objektit industrial.

9.1.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Gjatë operimit të thertores dhe mishtores nga “ERONA COMPANY” Sh.P.K., ndikimet në cilësinë e ajrit janë të kufizuara, por të pranishme, ndaj është e domosdoshme zbatimi i masave parandaluese dhe zbutëse për të siguruar që aktiviteti industrial të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore dhe të mos cenojë mirëqenien e komunitetit lokal. Disa nga masat janë:

- Menaxhimi i shpejtë dhe i kontrolluar i mbetjeve organike përmes grumbullimit në kontejnerë të mbyllur dhe largimit të rregullt.
- Pastrim i shpeshtë i ambienteve të punës për të parandaluar gjenerimin e aromave të pakëndshme.
- Ajrosje adekuate përmes sistemit të ventilimit.
- Mirëmbajtje teknike e automjeteve për të minimizuar emetimet e gazrave dhe grimcave.
- Përdorim i mjeteve transportuese që përmbushin normat evropiane të emetimit të ndotësve në ajër.

9.2.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë.

Në mënyrë që të minimizohet ndikimi i mundshëm në cilësinë e tokës, gjatë funksionimit të thertores dhe mishtores në zonën kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës, janë planifikuar dhe zbatohen masat në vijim:

- Sistemi i kanalizimit është i mbyllur dhe i lidhur me një gropë septike të izoluar, për të parandaluar çdo rrjedhje në tokë, ku pas trajtimit, shkarkohet në kanalizimin e fshatit;
- Mbetjet e ngurta organike që krijohen nga procesi i therjes dhe përpunimit grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe dorëzohen te operatorë të licencuar për trajtim të mëtejshëm;

- Pastrimi i përditshëm i hapësirave të punës realizohet për të shmangur grumbullimin e mbetjeve dhe kontaminimin potencial të tokës;
- Kryhen kontrole periodike teknike mbi funksionalitetin e gropës septike dhe sistemit të kanalizimit, për të identifikuar çdo problem të mundshëm;

9.3.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Kompania ka implementuar një sistem të mbyllur të kanalizimit ku ujërat e ndotura drejtohen në një gropë septike të ndërtuar sipas standardeve teknike dhe higjieno-sanitare, duke minimizuar në këtë mënyrë rrezikun e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore. Për të siguruar vazhdimësinë dhe efikasitetin e këtij sistemi, rekomandohen masat e mëposhtme:

- Kryerja e kontroleve periodike teknike për të verifikuar funksionimin dhe integritetin e sistemit të kanalizimit dhe gropës septike;
- Organizimi i pastrimeve dhe zbrazjeve të rregullta të gropës septike nga operatorë të licencuar;
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit për menaxhimin e duhur të ujërave të ndotura dhe parandalimin e ndotjeve aksidentale;
- Mbajtja e një plani emergjent për reagim në rast prishjesh apo defekte të sistemit.

9.4.Masat për mbrojtje nga zhurma

Të bëhet matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës, por në rastin e zhurmës është minimale.

9.5.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Edhe pse ndikimet aktuale në peizazh, florë dhe faunë janë minimale, rekomandohet që të zbatohen masa parandaluese për të ruajtur këtë gjendje dhe për të parandaluar çdo ndikim të mundshëm afatgjatë, si:

- Monitorimi periodik i zonës për të vëzhguar ndryshimet në florë dhe faunë dhe për të identifikuar shenja të ndikimeve të padëshiruara;
- Kujdes i veçantë në menaxhimin dhe grumbullimin e mbetjeve, për të parandaluar përhapjen e ndotësve në mjedisin natyror;

- Sigurimi i barrierave natyrore apo mekanike për të shmangur depërtimin e mbetjeve në habitatet përreth;

9.6.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të siguruar që veprimtaria e objektit të mos ketë ndikime negative në shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së banorëve lokalë, janë ndërmarrë masat e mëposhtme:

- Zbatimi i sistemit të mbyllur për trajtimin e ujërave të ndotura, përmes gropos septike të ndërtuar sipas standardeve, me qëllim shmangien e ndotjes së mjedisit dhe ujërave nëntokësore;
- Përpunimi dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta në mënyrë të kontrolluar dhe dorëzimi i tyre te operatorë të licencuar për menaxhimin e mbetjeve;
- Respektimi i kushteve higjieno-sanitare në hapësirat e punës dhe rreth objektit, për të parandaluar përhapjen e aromave të pakëndshme dhe kontaminimeve;
- Krijimi i vendeve të reja të punës për banorët lokalë, duke kontribuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës;
- Zbatimi i praktikave të rregullta të pastrimit dhe dezinfektimit për të siguruar një ambient të sigurt për punëtorët dhe komunitetin përreth;

9.7.Masat për menaxhimin e mbeturinave

Për të parandaluar ndikimet negative mjedisore që lidhen me krijimin dhe trajtimin e mbeturinave gjatë operimit të thertoresh dhe mishtores, janë zbatuar këto masa:

- Mbetjet organike që krijohen gjatë procesit të therjes ruhen në kushte të kontrolluara dhe dërgohen në mënyrë të rregullt për trajtim nga kompani të licencuara, në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe higjieno-sanitar në fuqi;
- Mbetjet komunale grumbullohen në kontejnerë të mbyllur, të cilët pastrohen dhe mirëmbahen rregullisht për të shmangur ndotjen dhe erërat e pakëndshme dhe për largimin e këtyre mbeturinave kompania i dërgon tek kompanitë për menaxhimin e mbeturinave nga Komuna e Gjakovës.

Tabela 1. Paraqitje e mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e Rrezikshmëris	Lloji i planifikuar për deponim të mbeturinave
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
02 02 02	Mbeturinat nga indet e shtazëve	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbetuima

1.1 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Përhapje e erërave të pakëndshme dhe ndotje e mundshme.	Procesi i therjes, grumbullimi i mbetjeve organike, lëvizja e mjeteve të transportit	- Ruajtje e mbetjeve organike në ambiente të mbyllura - Transport i rregullt nga kompani të licencuara - Pastrim dhe dezinfektim periodik i hapësirave operative
Uji dhe Toka	Ndikimi minimal	Përpunimi i ujërave të ndotura, rrjedhjet e mundshme nga kanalizimi. Rrjedhja dhe depozitimi i pa kontrolluar i mbetjeve dhe ujërave	- Sistem kanalizimi i mbyllur dhe gropë septike e mirëmbajtur - Kontroll periodik i sistemit dhe zbrazje nga operatorë licencuar - Grumbullim dhe dorëzim i kontrolluar i mbetjeve - Pastrim i përditshëm i hapësirave të punës
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	Ndikimi minimal	Përhapja e ndotësve, prishja e habitatit, zhurma	- Monitorim periodik i florës dhe faunës - Menaxhim i kujdesshëm i mbetjeve për të parandaluar ndotjen - Parandalim i ndërhyrjeve të panevojshme në zonat natyrore dhe të mbrojtura
Zhurma	Potencial minimal .	Përdorimi i makinerive, automjeteve dhe procesi industrial	- Matje periodike e nivelit të zhurmës pranë banesave - Krahasim me standardet ligjore

Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial minimal	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës manipuluese.	Të gjitha pajisjet të cilat mund të kenë ndikime në shëndetin e qytetareve do t’iu kushtohet rëndësi e veçan në mirëmbajtjen e tyre.
--	-------------------	---	--

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me thertoren dhe mishtoren nga kompania "ERONA COMPANY" Sh.P.K., në zonat kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës, mundësitë për pasojat negative mjedisore nga aksidentet ose katastrofat janë të kufizuara. Megjithatë, ndodhin mundësi të caktuara rreziku, kryesisht në lidhje me përdorimin e energjisë elektrike dhe pajisjeve mekanike. Për shembull, mund të ndodhin aksidente si pasojë e defekteve në instalimet elektrike ose të makinerive, të cilat mund të shkaktojnë zjarr. Në këtë kuadër, fabrika ka marrë masa të plota mbrojtëse, duke siguruar pajisje për fikjen e zjarrit si dhe hidrantë të brendshëm për ndihmën emergjente, për të minimizuar çdo rrezik potencial.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe raportimi janë komponentë thelbësorë të menaxhimit mjedisor për operimin e thertoresh dhe mishtore në parcelat 01064-2 dhe 01070-0, në zonën kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës. Këto procese janë të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregulloret mjedisore, për të vlerësuar ndikimin aktual në mjedis dhe për të promovuar përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore të impiantit.

Më poshtë janë paraqitur metodat dhe praktikrat që do të zbatohen për monitorim dhe raportim:

Monitorimi i Ajrit

- **Monitorimi i Cilësisë së Ajrit:** Do të realizohet nga kompani të licencuara për matjen e ndotjes në ajër, me fokus në monitorimin e emisioneve të mundshme nga procesi i përpunimit dhe trajtimit të mbetjeve organike. Qëllimi është të vlerësohet ndikimi në cilësinë e ajrit dhe të sigurohet përputhshmëri me standardet ligjore.
- **Matja e Emetimeve nga Pajisjet dhe Makineritë:** Do të kryhen matje të rregullta për të kontrolluar nivelin e gazrave që çlirohen nga pajisjet dhe automjetet e përdorura në procesin e therjes dhe transportit të produkteve.

Monitorimi i Ujit dhe Kanalizimeve

- **Monitorimi i rrjedhjeve dhe kanalizimeve:** Do të kontrollohen rregullisht rrjetet e kanalizimeve dhe gropat septike për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore.

Monitorimi i Zhurmës

- **Matja e Nivelit të Zhurmës:** Do të kryhet në brendi dhe rrethinat e objektit me pajisje adekuate për matjen e decibelëve, për të verifikuar respektimin e kufijve të lejuar nga legjislacioni.

Monitorimi i Tokës dhe Mbeturinave

- **Kontrolli i mbeturinave:** Do të bëhet inspektim periodik i mënyrës së grumbullimit dhe transportit të mbetjeve organike dhe mbetjeve të ngurta, për të parandaluar kontaminimin e tokës.

Raportimi mjedisor do të realizohet nga personeli i autorizuar i caktuar nga menaxheri i kompanisë, në bashkëpunim me ekspertët përgjegjës mjedisor të brendshëm dhe të jashtëm.

Raportet do të përmbajnë:

- Të dhëna për matjet dhe analizat e realizuara sipas kërkesave të Pëlqimit Mjedisor;
- Vlerësime të përputhshmërisë me standardet ligjore;
- Masa korrigjuese në rast të devijimeve nga standardet;
- Rekomandime për përmirësim të mëtejshëm të performancës mjedisore.

Raportet do të dorëzohen në kohë tek autoritetet përkatëse si Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Drejtoria Komunale e Mjedisit në Gjakovë, në përputhje me frekuencën e përcaktuar në legjislacion.

12. PËRFUNDIM

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme mjedisore, vlerësimin e masave parandaluese dhe lehtësuese, si dhe duke u mbështetur në dokumentacionin ekzistues dhe projektet e planifikuara për zbatim, mund të nxjerrim përfundimet si më poshtë:

Thertorja dhe mishtorja, ndërtuar nga investitori privat në parcelën 01070-0, zona kadastrale Rogovë I, Komuna e Gjakovës, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të therjes dhe përpunimit të mishit në mënyrë higjienike, të kontrolluar dhe me standarde të larta, për të përmbushur nevojat e tregut lokal dhe rajonal.

Ky projekt paraqet një interes të shumë anshëm:

- Në interes të investitorit për të përmirësuar kushtet dhe efikasitetin e punës
- Në interes të Komunës së Gjakovës, duke krijuar vende të reja pune, rritur të hyrat komunale përmes taksave dhe duke përmirësuar infrastrukturën lokale;
- Në interes të banorëve lokalë, të cilët përfitojnë nga krijimi i vendeve të punës, mundësitë për shitjen e produkteve të mishit, si dhe përmirësimi i kushteve të përgjithshme mjedisore përmes menaxhimit të duhur të mbetjeve.

Nëse thertorja dhe objekti për përpunimin e mishit mirëmbahen sipas standardeve të përcaktuara në këtë raport, duke respektuar të gjitha masat mjedisore të parashtruara dhe në bashkëpunim me autoritetet kompetente, atëherë ky projekt konsiderohet i pranueshëm nga aspekti mjedisor, social dhe ekonomik.

Duke u bazuar në:

- Natyrën e aktivitetit të projektit,
- Vendndodhjen dhe distancat nga zonat e banuara,
- Kapacitetin dhe intensitetin e operimit, si dhe
- Masat e propozuara për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve,

mund të konstatohet se ndikimet e projektit në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin përreth janë minimale dhe të menaxhueshme. Për këtë arsye, konsiderojmë se të dhënat dhe analizat e paraqitura në këtë raport janë të mjaftueshme për përfundimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe i propozojmë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të japë mendim pozitiv për dhënien e Pëlqimit Mjedisor për këtë projekt, sipas kërkesës së investitorit.

13. FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE

TABELA E KOST – THERTORE DHE MISHTORE “ERONA COMPANY”SH.P.K.			
Nr.	Emri	Çmimi (€)	Totali (€)
1.	Pajisje për therje dhe prerje të mishit	5,000	28,000.00
2.	Pajisje për përpunim, grirje dhe paketim të mishit	7,500	30,000.00
3.	Pajisje frigoriferike për ruajtjen e mishit	3,500	20,000.00
4.	Mjete transporti për mish (automjete me frigorifer)	15,500	17,000.00
Shuma totale investive			95,000.00 €

“ERONA COMPANY” SH.P.K.

14. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- [Plani-Zhvillimor-Komunal-2022-2030_compressed-1.pdf](#)
- [Gjakova to 42.3316504, 20.5789600 - Google Maps](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS](#)